



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË LUSHNJE

PROCESVERBAL
PËR ARRESTIMIN NË FLAGRANCË

Në Lushnje me 28.10.2014, ora 13:40 unë Ilirjan Hila Oficer i Policisë Gjyqësore, në bazë të neneve 297, 155 - 160 e vijues të K. Pr. Penale, mbaj këtë procesverbal për arrestimin në flagrancë të shtetasit : Qamil Zela , i biri i Muço , dhe Behije , lindur me 21.09.1962 në Lushnje , gjinia mashkull , kombësia shqiptare , shtetësia shqiptare , arsimi 8 klase , profesioni vetpunësuar , gjendja familjare martuar dhe me tre fëmije, banues ne L.Skender Libohova Lushnje , tel 035224522 , i pa denuar me pare, i vet identifikuar.

Arrestimi u krye pasi ai u kap në flagrancë për kryerjen e veprës penale "Vjedhja e energjise elektrike ose impulseve telefonike" parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal , që ka ndodhur në rrethanat si më poshtë:

Me dt.28.10.2014 rreth ores 12:30 ne objektin e ketij shtetasi ne L.Skender Libohova Lushnje eshte konstatuar se dy dyqanet e tij te cilat jane gjetur ne pune dhe me energji elektrike , nuk ishin te pajisur me matesa elektrik dhe as me kontrata nga CEZ shperndarje. Energjine elektrike keto dy dyqane e merrnin ne menyre te paligjshme nga matesi i baneses se ketij shtetasi duke vjedhur energjine elektrike nga abonenti familjar pasi dhe energjia elektrike shitet me cmim me te lire per abonentin familjar se per bizneset.

Të arrestuarit në flagrancë iu bë e ditur se në bazë të nenit 255 ka të drejtë të ketë mbrojtës, se nuk ka detyrim të bejë deklarata dhe në qofte se do të flasë, çfardo që ai thotë, mund të përdoret ndaj tij në gjykim.

I arrestuari deklaroi se nuk do avokat per momentin.

Procesverbali i arrestimit në flagrancë lexohet dhe nënshkruhet pa verejtje. Një kopje e këtij procesverbali i dërgohet prokurorit , nje kopje i dorezohet te arrestuarit ne flagrance dhe nje kopje i jepet pergjegjesit te dhomave te sigurise Ndriçim Mitrovica .

Me pëlqimin e të arrestuarit u njoftuan familjaret e tij.

I ARRESTUARI NË FLAGRANCË

Qamil Zela

OFICERI I POLICISË GJYQËSORE

Ilirjan Hila

Ilirjan Hila